



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri
Tel: 00 355 42240978
info@ukt.al
NIPT L72320033P

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ____ / ____ / 2018

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: **BO” I T E GRUP sh.p.k & FASTECH sh.p.k & ABCOM sh.p.k**

Procedura e prokurimit: **“E hapur”**.

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-82683-08-10-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje Sistem Kamerash” me fond limit 51,969.924 (pesëdhjetë e një milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë nëntëqind e njëzetë e katër) lekë pa tvsh**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “BO” I T E Grup ”sh.p.k & Abcom h.p.k & Fastech sh.p.k
K11323001H K11308001B J81609010U

Vlera 39.000.000 (tridhjetë e nëntë milion) lekë pa tvsh.

2. Advanced Bussiness Solution (ABS) sh.p.k & Aurora Konstruksion sh.p.k

K21710002J & K02017003I

Vlera 43.547.000 (dyzetë e tre mijë e pesëqind e dyzetë e shtatë mijë) lekë pa tvsh.

3.Communications Group sh.p.k

K01625001C

Vlera 45.023.770(dyzetë e pesë milion e njëzetë e tre mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë)lekë pa tvsh.

4.B 360 sh.p.k

Vlera 0(zero)

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1.B 360 sh.p.k

Vlera 0(zero)

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “**B360**” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën e DT.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “**B360**” shpk s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 8, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreut VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

2.Communications Group sh.p.k

K01625001C

Vlera 45.023.770(dyzetë e pesë milion e njëzetë e tre mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë)lekë pa tvsh.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ku rezultoi si më poshtë vijon:

Së pari AK ka AK ka kërkuar në DS T kriteret e veçanta të kualifikimit ,pika 2 d)si më poshtë vijon:

d. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik në sistemin elektronik Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori pjesëmarrës nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion për të dëshmuar plotësimin e kriterit të kërkuar në DST.

Theksojmë se në shtojcën 9 të DST citohet se ...**Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

Në këtë rast K.V.O është e detyruar të zbatojë nenin 55 /2 të ligjit nr.9643,datë 20.11.2006”Për prokurimin Publik” në të cilën citohet se ...Autoriteti Kontraktor vlereson dhe krahason ofertat e vlefshme për të percaktuar ofertën fituese në përputhje me procedurat dhe kriteret e percaktuara në dokumentat e tenderit.

Së dyti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 7 si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë 3 viteve të fundit (nga data e zhvillimit të tenderit) me një vlerë sa 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet ose 20.787.969(njëzetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë)lekë pa tvsh.

- Kur furnizimi i ngjashëm i mëparshëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate. Kur furnizimi i mëparshëm i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur faturat përkatëse tatimore ku të jetë shënuar datat, shuma, sasia e mallrave të furnizuara, të nënshkruar nga të dyja palët.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit KVO vëren se operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dokumentacionin e kërkuar për të provuar përmbushjen e kriterit 7 të kërkuar në DST.

*Sqarojmë operatorin ekonomik se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, **përvojën e duhur**, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.*

Kriteret kualifikuese të percaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi dhe është detyrë e operatorëve ekonomikë të dorëzojnë ofertën në përputhje me dokumentet e tenderit dhe kërkesat e autoritetit kontraktor.

Përsa më sipër KVO gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik Communication Progres është i paplotë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu

VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“BO” I .T E GRUP sh.p.k &FASTECH sh.p.k &ABCOM sh.p.k** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 39.000.000(tridhjetë e nëntë milion)lekë pa tvsh se pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë UKT sh.a sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të vijohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 13.12.2018

Ankesa: **JO**

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

